

2 **Ditët e protestës**
Vjeshtë me aksione
sindikaliste
në ndërtime

3 **Studimi: hendekun**
në paga Vetëm një grua
në mesin e drejtorëve
ekzekutiv

4 **Jubileu i Horizonte**
Para 20 viteve,
me 12.10.1998 doli
numri i parë

Nr. 6 | tetor 2018 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Votimet e 25 nëntorit 2018

Sulm mbi të drejtat tona dhe sferën private



Kundër përpjekjeve për të zyrtarizuar vëzhgimet që çenojnë sferën private të të siguruarve

Më 25 nëntor do të votohet për dy çështje me rëndësi. Nën petkun e «vetëvendosjes», SVP/UDC (Partia Popullore e Zvicrës) përmes iniciativës «drejtësi zvicere në vend të gjyqtarëve të huaj» ia mësynë të drejtave njerëzore dhe atyre të punëmarrësve. Kësaj iniciative sindikata Unia i thotë qartas JO. Votimi tjetër popullor është kundër ligjit, i cili venë në pikëpyetje të drejtën për sferën private. Ky ligj i lejon detektivëve privat që pa leje a vendim të gjykatës të përgjojnë në dhoma banime dhe ballkone. Unia thotë JO!

Ligji i observimit: Sukses i lobit të sigurimeve

Në tetor të vitit 2016 Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut erdhi në përfundim, se observimi i personave, të cilët dyshohen për keqpërdorim sigurimesh, është i palejueshëm, pasi në legjislacionin zviceran të sigurimeve sociale për këtë mungon baza ligjore. Për të mbyllur këtë zbrazëti parlamenti federal i Zvicrës ka vu në binar revizionin ligjor të nenit për observim. Ligji i ri përbushë të gjitha dëshirat e kompanive të sigurimeve.

Të gjithë të siguruarit nën dyshim të përgjithshëm

Sipas ligjit sigurimet sociale guxojnë që përfituesit e pensioneve të invaliditetit (IV/AI) dhe të pleqërisë (AHV/AVS), të siguruarit në rast të papunësisë dhe të siguruarve shëndetësor, në rast të dyshimit të observojnë përmes fotografive dhe regjistrimit zanor duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve dhe instrumente teknike.

Vëzhgimet lejohen gjithashtu në vende që janë lirisht të dukshme nga një vend publik, si kopshti ose ballkoni i personit në fjalë. Kjo sigurimeve shoqërore u jep kompetenca mbikëqyrëse, disa prej të cilave shkojnë përtej atyre të zyrtarëve në procedurat penale apo të shërbimeve të zbulimit.

Qëndrimet zyrtare mbi referendumin

Që mashtrimet e sigurimeve duhet të trajtohen është jashtë diskutimit për organizatat që i janë bashkuar komitetit të referendumin. Por të drejtat themelore dhe parimi i proporcionalitetit duhet të respektohen.

Iniciativa «vetëvendosëse»: sulm ndaj të drejtave të njeriut dhe demokracisë

Për të parandaluar luftërat dhe konfliktin e interesave, shtet negociojnë dhe lidhin me njëri-tjetrin marrëveshje bazuar në ligjet ndërkombëtare. Duke anuluar

traktatet ndërkombëtare siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR), iniciativa «vetëvendosëse» sulmon drejtpërdrejt të drejtat e njeriut dhe të punës. Kjo konventë na garanton, mes shumë të tjerave, lirinë e mendimit, fesë dhe ndërgjegjes, të drejtën për një gjykim të drejtë, mbrojtjen kundër diskriminimit... Ruajtja e këtyre të drejtave është thelbësore në një demokraci. Kushdo që e vë në pikëpyetje këtë vë në rrezik sistemin ligjor dhe demokracinë.

Sulm ndaj të drejtave tona të punës

Ligji zviceran i punës dhe liria e sindikatave çalon prapa vendeve të tjera. Në rastet, fjala bie, të shkarkimeve abuzive, sindikatat ankohen apo ngritin padi në Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO). Që nga viti 1919, kjo organizatë e specializuar e Kombeve të Bashkuara ka promovuar drejtësinë sociale, si dhe të drejtat e njeriut

dhe të punës. Nëse iniciativa pranohet, Zvicra mund të detyrohet të heqë dorë nga konventat e ILO-s. Sindikatat do të humbnin mundësinë e ankesës së tyre.

Asnjë mbrojtje më nga e drejta ndërkombëtare

Në kundërshtim me atë që thonë iniciatorët, e drejta ndërkombëtare nuk e vë në dyshim demokracinë tonë, ne gjithmonë mund të votojmë për referendume dhe nisim. Por e drejta ndërkombëtare është një ombrellë e nevojshme mbrojtëse dhe siguria jonë e fundit. Iniciativa dëshiron ta mbyllë këtë ombrellë mbrojtëse. Pasoja do të ishin: Ne humbim të drejtat qendrore njerëzore dhe të punës, Zvicra mbetet e izoluar nga bota dhe sillet në një mënyrë jo solidarë.

Më 25 nëntor, Unia thotë: JO për nisim të «vetëvendosëse»; JO spiunëve privat të sigurimeve!

Osman Osmani dhe Marília Mendes

Editorial



Greva ia vlen

Para 100 vitesh, në nëntor të vitit 1918 erdhe deri tek greva më e madhe historike në Zvicër. 250 000 punëtorë e punëtorë ndërprejnë për tri ditë të tëra punën. Kështu ata iu përgjigjën krizës së thellë ekonomike e sociale. Një pjesë e madhe e popullatës asokohe ishte e varfëruar. Me dhjetëra mijëra mund të ushqeheshin vetëm falë supave nga kuzhinat publike. Greva e përgjithshme kërkonte reforma sociale e demokratike: Ulja e çmimit për qumësht dhe artikuj tjerë themelor të ushqimit; pensione të pleqërisë për të gjithë; reduktimin e orarit të punës në 8 orë në ditë; futja e të drejtës së votës për gratë. Përgjigja e qeverisë ishte brutale, ajo angazhoi ushtrinë kundër grevistëve, disa punëtorë u qëlluan për vdekje. Pas kësaj drejtuesit e grevës e ndërprejnë aksionin. Mirëpo kjo lëvizje nuk shkoi kot. Qeveria dhe punëdhënësit u detyruan të bënin koncesione të mëdha: Pagat u ngritën, orari i punës u reduktua në 8 orë në ditë. Filloi krijimi i sistemit të pensionit të pleqërisë dhe trashëgimisë. Greva më e madhe në historinë e Zvicrës, pra ia kishte vlejtur!

Edhe tani në Zvicër bëjnë grevë punëtorët e punëtorët, nëse nuk gjejnë rrugë tjetër: kundër shkarkimit masiv, kundër shkurtimeve në pagë, kundër përkeqësimit të kushteve të punës. Edhe tani shumica e këtyre betejave janë të suksesshme. Punëtorët e ndërtimeve përmes grevës kanë arritur pensionimin me 60 vjet dhe kanë fituar me luftë një kontratë kolektive të mirë pune. Pasi punëdhënësit tani atakojnë këtë o të arritura, në muajt e ardhshëm në ndërtimeve presin greva të reja të mëdha.

Andreas Rieger

News

Rasti i vdekjes së Mira Koamromit

Me keqardhje kemi mësuar për lajmin e vdekjes së Mira Komaromit. Ajo vdiq më 29.09.2018 në moshën 70 vjeçare në Cyrih. Mira ishte ish-punonjëse e sindikatës Unia në sektorin për migracionit. Ndër të tjera, Mira ka qenë e përfshirë në ekipin redaktues të gazetës sonë «Horizonte» të edicionit në gjuhën serbe-kroate-boshnjake dhe në atë shqipe. Ne shprehim ngushëllimet tona të sinqerta për familjen dhe të afërmit e Miras.

Kopshtarët/et angazhohen për kushte më të mira pune – edhe pa ndihmën e Xhejms Bondit

Përmes një aksioni spektakël kopshtarët/ët e Cyrihut me 1 tetor 2018 kanë tërhequr vëmendjen për kushtet e këqija të punës në degën e tyre. Ata duan të luftojnë bashkërisht për ardhmërinë e kopshtari-ndërtimit – dhe me këtë rast nuk e kanë të nevojshme ndihmën e Xhejms Bondit, siç tregon edhe filmi i krijuar për këtë rast. Ata ditë për ditë janë jashtë – qoftë në temperaturat minus dimrit apo kësaj vere me temperatura mbi 30 gradë. Kjo përditshmëri pune është e vështirë dhe rraskapitëse. Megjithatë ata/o fitojnë rreth 1000 franga më pak se sa kolegët/et e tyre nga ndërtimtaria kryesore, kanë më pak pushime vjetore dhe nuk kanë mundësi për dalje në pension të mëhershëm.

Shitësit me pakicë duan rroga më të mira

Shitësit me pakicë në fund të shtatorit në konferencën e Unia-s në Bernë kanë kërkuar rritjen e pagave reale. Për-pjekjet e tyre të mëdha për produktiviteti meritojnë që ata të shpërblehen me një rritje të fuqisë blerëse. Rreth 50 delegatë kanë diskutuar edhe për ndikimin e digjitalizimit në degën e tyre dhe për perspektivat ndërlidhëse. Pas të punësuarve të Coop-it, po këto kërkesa për rritje prej 2,5% të pagës për vitin e ardhshëm shtruan të punësuarit e shitoreve në pikave e karburanteve, së paku gjysma të jetë rritje e përgjithshme.



Arkat vetë-shërbyese: më shumë stres për personelin shitës

Një studim i Universitetit të Bernës me porosi të sindikata Unia, tregon që pasojat për të punësuarit e digjitalizimit për sistemet e arkave nëpër supermarkete janë të rënda: më shumë stres, ngarkesë trupore dhe përqendrim i kontaktit me myshterinj/e. Tregtuesit e mëdhenj kursejnë përmes arkave vetë-shërbyese, veçanërisht tek personeli dhe hapësira: andaj për këtë arsye do të duhej të reflektohej me kushte më të mira pune dhe paga më të larta për punësuarit.

Ditët e protestës në ndërtimtari Vjeshtë me aksione sindikaliste

Konflikti në kantiere e ndërtimit po përshkallëzohet. KKP përfundon dhe pensionimi me 60 vjet duhet të sigurohet. Me kërkesat e tyre maksimale, pronarët e ndërtimit po pengojnë me muaj të tërë zgjidhjen. Punëtorët e ndërtimtarisë janë të pakënaqur: ata do të luftojnë për të drejtat e tyre – me aksione proteste në të gjithë Zvicrën.

Konflikti në ndërtimtari po përkeqësohet. Për muaj të tërë, shoqata e pronarëve të ndërtimit refuzoi të negociojë dhe tani përpiqet të shantazhojë punëtorët e ndërtimtarisë. Pas demonstrimit të 18000 punëtorëve të ndërtimtarisë në qershor, shoqata e pronarëve të ndërtimit më në fund u tregua e gatshme për të negociuar, dhe në horizont dukën zgjidhjet në lidhje me pensionimin me 60 vjet si dhe rritjen e pagave. Por, shoqata e pronarëve është e gatshme të zbatojë këtë, vetëm nëse sindikatat aprovojnë shkurtimet në KKP.

12 orë pune në ditë në rast nevojë

Por: qysh tani ditët e punës për punëtorët e ndërtimtarisë janë të gjata. Tani duhen të mundësohen 300 orë fleksibel dhe të bëhet normë e re standarde 12 orë punë në ditë. Kjo është e paarsyeshme. Në të njëjtën kohë shoqata e pronarëve donë që punëtorët e moshuar, pas ndërrimit të vendin e punës ti zhvendosin në një shkallë më të ultë të pagës; dhe firmave nga jashtë Zvicrës tu mundësojë që punëtorët e tyre ti dërgojë këtu si «praktikantë» me paga



Punëtorët e ndërtimtarisë mbrojnë pensionimin me 60

tejet të ulëta. Kjo hapë dyer e dritare për dumpingun në paga; barrën e pasojave e bartin firmat zvicerane dhe të punësuarit e tyre.

Durimi i punëtorëve të ndërtimtarisë merr fund

Nuk është për tu çuditur që durimit të punëtorëve të ndërtimtarisë i ka ardhur fundi. Ata luftojnë për pensionimin me 60 vjet, kundër dumpingut në paga dhe ditëve të stërgjata të punës, të cilat rrezikojnë shëndetin e tyre – me ditë të protestës në të gjithë Zvicrën.

Lena Frank



Pamje nga demonstrata e punëtorëve të ndërtimtarisë në qershor 2018 në Cyrih

Manuel Beja ish sekretari për migracion na ka lënë Luftëtar i palodhshëm sindikalist

Të panumërta ishin betejat e Manuel Beja për të drejtat e punëtorëve të huaj, veçanërisht për ata portugez. Shoku i palodhshëm në luftën për drejtësi sociale dhe solidaritet ka humbur betejën e tij të fundit. Manuel Beja vdiq me 29 shtator 2018 në spitalin Alcobaça të Portugalisë.

Nga 260000 portugezët që jetojnë në Zvicër gati 30000 prej tyre janë anëtarë të Unia. Kjo kryesisht falë punës pioniere të Manuel Bejës, i cili në të gjithë Zvicrën informonte migrantët, posaçërisht arta portugezë, mbi të drejtat e tyre, rëndësinë e sindikatave dhe mobilizimin për çështje sindikaliste dhe sociale. Në rrugëtimin për barazi sociale, ai me veti morri eshë shumë sekretarë portugez dhe ishte shembull për angazhimin bindës.

Rrugëtimi i gjatë me sindikatë

Manuel Beja (*1945 në Alcobaça) erdhi në Zvicër në vitin 1971. Si kundërshtar i diktaturës fashiste ai ishte përndjekur nga PIDE (policia politike) dhe u detyrua që në vitin 1967 të arratiset nga Portugalia. Pas Parisit dhe Holandës ai erdhe në Zvicër, në të cilën jetoi në ilegalitet deri në vitin 1974, pasi ishte refuzuar kërkesa e tij për azil politik. Në këtë vit ai u kthye në Portugali, për të marrë pjesë në revolucionin e karafilave. Në vitin 1976 u kthye përsëri në Zvicër dhe rifilloi punën si dekorator, profesion ky që e kishte mësuar në Paris.

Më 1989 e ftoi Vasco Pedrina, ish sekretari i atëhershëm për migracion, që ti bashkëngjitet sindikatës së ndërtimtarisë dhe drurit (GBH-SBB-SEL). Kështu Manuel Beja u bë sekretar, përgjegjës për përkujdesjen e anëtarëve portugez në nivelin nacional.

Rrugët e shumta të betejave

Ky ishte fillimi i mbledhjeve të shumta të tij me anëtarë në të gjithë Zvicrën. Për Manuel Bejen më e rëndësishmja ishte kontakti i drejtpërdrejtë me njerëzit. Pa u lodhur nuk



hoqi dorë asnjëherë të angazhohej për portugezët, si fjala bie në betejën kundër statusit të stinorëve.

Edhe reforma e vitit 2017 nuk mundi ta frenonte atë. Ai ishte pjesëmarrës në lëvizjen e asociacioneve dhe fuqizoi rritjen e saj në Zvicër. Si anëtar i këshillit të migrantëve portugez kultivonte kontaktet, dëgjonte problemet, informonte dhe mbronte portugezët. Në shenjë mirënjohjeje, iu dha Urdhri i Meritës nga Presidenca e Republikës.

Lufta vazhdoi më tej

Manuel tërë jetën e tij ia kushtoi luftës për vizionin e tij të një shoqërie të drejtë. Ai mbështeti deri në fund lëvizjen sindikaliste, edhe atëherë kur e shihte me sy kritik. I vetëdijshëm për rëndësinë e përkujtimin, ai në vitin 2017 morri pjesë në një projekt të Unia, i cili kishte për qëllim mbledhjen e dëshmimeve nga ish punëtorët. Një pjesë të intervistës së tij në gjermanisht mund të dëgjohet në vegën vijuese: <https://bit.ly/2CwBimC>

Manuel Beja na ka lënë në trashëgimi një leksion shembullorë të angazhimit të tij për sigurimin e të drejtave tona. Nderi më i mirë, të cilin ne mund t'ia bëjmë, është që të vazhdojmë luftën e tij dhe tonën.

Marília Mendes

20 000 njerëz në demonstratën e grave Për barazi në paga dhe kundër diskriminimit!

Me 22 shtator 20000 njerëz nuk deshën të pajtohen me padrejtësinë dhe dolën në rrugë për ti dhënë fund pabarazisë skandaloze. Mandati kushtetues për barazinë në paga ka 37 vite që është i qartë për këshillin federal: masa efektive për pagesë të barabartë! Gratë me sfond migracioni i nënshtrohen diskriminimit të dyfishtë. Në një të anë si gra, në tjetër si migrante.

Demonstruesit ndër të tjera kërkuan masa efektive në ligjin për barazi: veçanërisht analiza të detyrueshme të pagave për të gjitha ndërmarrjet, përshtatjen e menjëhershme të pagave diskriminuese për gratë dhe gjopa të larta, në rast se ndërmarrja nuk respekton ligjin e vlefshëm.

Vjedhje skandaloze në pagë

Dallimi në paga mes grave dhe burrave arrin 20 përqindësin skandaloz. Faktor të ndryshëm diskriminues i kontribuojnë kësaj gjendjeje: kështu pagat në profesionet tipike të grave janë më të ulëta, gratë ushtrojnë më pak funksione drejtuese, punojnë më shumë me orare të pjesshëm, për të mundur të baraspeshojnë profesionin me familje. «Edhe

nëse marrim parasysh justifikimet e zakonshme dhe duke krahasuar një grua dhe një burrë në pozicione krejtësisht të njëjta e me të njëjtën përvojë pune, etj., mbetet fakti se një grua në Zvicër në jetën e saj profesionale është mashtruar për 300 000 franga të plota, dhe atë nga shkaku i vetëm se ajo është një grua!» thekson Corinne Schärer, ish anëtare e drejtorisë qendrore në Unia.

Bashkë me organizata dhe sindikata tjera Unia për vitin 2019 është duke u përgatitur një grevë të grave, për të zbatuar më në fund të drejtat dhe barazinë e grave.

Emine Sariaslan



Pamje nga demonstrata madhështore e grave zhvilluar me 22 shtator 2018

Studim mbi hendekun e pagave Vetëm një grua në mesin e CEO-ve më të lartë

Hendeku i pagave në 2017 ka ra pak, por ende është në një nivel të lartë. Pagat e larta vazhdojnë të rrjedhin në xhepat e CEO-ve (drejtorëve ekzekutiv) mashkullor – me përjashtim të një gruaje. Fakt është: Pesë vjet pas miratimit të iniciativës gllabëruese, pagat tepër të larta të menaxherëve shumë pak kanë ndryshuar.

Unia hulumton në studimin e saj vjetor hendekun në pagat më të larta dhe më të ulëta në 39 ndërmarrjet më të mëdha zvicerane. Me 2017 hendeku në paga shkoi për 14% më poshtë, megjithatë edhe më tej mbetej 1:143 (1:164 në vitin paraprak). Gllabëruesit më të mëdhenj, UBS-CEO Sergio Ermotti, ka një pagë bruto prej 14 202 000 franga dhe ka fituar në vitin 2017 për 3,6% më shumë se sa në vitin 2016.

CEO femra, një utopi


Një grua e vetme është e ulur në etazhin e shefave të ndërmarrjeve të mëdha: Jasmin Staiblin, CEO në Alpiq. Në vitin 2017 ajo fitoi 2 milion franga. Në rangun e listën ajo gjendet e fundit në radhën e tretë. Gratë janë të nën

përfaqësuar në etazhin e shefave. Kjo është një arsye më shumë që gratë në përgjithësi edhe më tej fitojnë 18,1% më pak se burrat.

Akoma kompensime të larta absurde

Fitimet e ndërmarrjeve të hulumtuara shkuan 24% mbrapa, mirëpo kompensimet (dhurimet) për CEO u reduktuan mesatarisht vetëm për 3,4%. Të 39 CEO-të bashkërisht fituan 172 miliona franga, me kompensimet e anëtarëve të drejtorisë qendrore kjo shumë arriti gati shifrën prej 1 miliard frangash. Përfundimi: pas 5 vitesh aprovim të iniciativës gllabëruese nuk ka ndryshuar thuajse asgjë.

Beat Baumann



10 hendeket më të larta në paga (Faktori mes pagës më të lartë dhe më të ulët) në ndërmarrje në vitin 2017

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Arka e papunësisë: A lejohen gjobimi me 18 ditë pune?

Ka kohë të gjatë që unë jam i papunë. Pasi unë fatkeqësisht gjithmonë marrë përgjigje negative në aplikimet e mija për vend pune, muajin e kaluar kam dërguar më pak aplikime pune, se sa ka kërkuar nga unë këshilltari i zyrës regjionale për ndërmjetësim pune. Për këtë unë kam marrë gjobë me heqjen e 18 ditëve të kompensimit. Kjo më duket gjobë e lartë, dhe unë shtroj pyetjen, se a është korrekte sjellja e këshilltarit të entit në fjalë?

Nicole Debrunner: Po, është korrekte. Si person i siguar duhet të plotësoni detyrimet që ju janë caktuar. Kjo domethënë se ju duhet të dorëzoni numrin e aplikimeve (përpjekjeve për të gjetur punë) të marrëveshura me këshilltarin tuaj të entit në fjalë. Për të përcaktuar lartësinë e sanksionimit enti në fjalë orientohet në të ashtuquajturën rregullore të sekretariatit shtetëror për ekonomi (Seco). Ju, më pastaj gjobiteni me 3 deri 4 ditë heqjeje kompensimi, nëse ju herën e parë keni dorëzuar më pak dëshmi përpjekjeje për të gjetur punë. Kësaj i shtohet edhe dorëzimi i përsëritshëm me vonesë i dëshmimeve për të gjetur punë: Për këtë me rregulloren në fjalë janë të parapara heqje të 10–19 ditëve kompensimi. Aktualisht afati më lartë i mundur sanksionues është 23 ditë, më i ulëti 13 ditë. Ashtu sikur mund ta shihni, sanksionimi që iu është bërë juve i bie në mes, andaj edhe është korrekt.

Work, 28.09.2018

Shkarkimi nga puna: a mund të më shkarkoi firma pas kërkesës për pagë?

Para dy javësh fola me shefen time : Unë I kërko-va më shumë rrogë, pasi unë fitoi më pak se është paraparë me Kontratën Kolektive të Punës. Para dy ditësh ma ka komunikuar shkarkimin nga puna. A është ky shkarkim i justifikueshëm?

Philip Thomas: Jo. Shkarkimi, menjëherë pasi keni kërkuar pagë më të lartë, lenë për të nënkuptuar se fjala është për shkarkim keqpërdorues. Një shkarkim është atëherë i keqpërdorur, kur dikush kërkon të drejtën bazuar në marrëdhënien në punë. Edhe kur shkarkimi është i pajustificueshëm, megjithatë ai vlen. Mirëpo, ju mund të kërkonit një dëmshpërblim. Për këtë ju duhet ta bëni kundërshtimin me shkrim në kuadër të afatit të përfundimit të shkarkimit dhe t'ia dërgoni firmës suaj.

Pastaj mund të provoni që të përputheni me shefen tuaj, se si mund të vazhdoi marrëdhënia e punës. Nëse kjo nuk qon në zgjidhje, atëherë ju keni mundësinë që brenda 180 ditësh pas përfundimit të marrëdhënies së punës të ankoheni tek gjyqtari. Gjyqtari më pas përcakton lartësinë e dëmshpërblimit. Maksimumi i gjashtë muajve mjerisht vetëm në raste të rralla arrihet të sigurohet. Në shumicën e rasteve aprovohen dy muaj pagë si dëmshpërblim. Vetëm nëse rrethanat janë tepër rënduese, atëherë gjyqtarët vendosin për më shumë. Nëse ankesën e dërgoni pas 180 ditësh, atëherë nuk keni më të drejtë në dëmshpërblim.

Work, 31.8.2018

Anketim i lexuesve–Horizonte 2018

Horizonti: Përvjetori dhe vështrimi në të ardhmen

Këtë vit, Horizonte feston 20 vjetorin e saj. Horizonte është një gazetë për anëtarët e Unia që flasin një gjuhë të huaj nga ato zyrtare të vendit. Ajo botohet shtatë herë në vit në pesë gjuhë dhe atë: në gjuhën portugeze, shqipe, spanjolle, serbo-kroate-boshnjake dhe turke –. Përveç kësaj, ekziston një botim i shkurtuar i horizonteve në gjuhën polake. Në këtë përvjetor të veçantë, ne duam të mësojmë nga lexuesit tanë se si e perceptojnë atë, që ta përmirësojmë atë. Andaj edhe e bëjmë këtë anketë. Qysh tani ju falënderojmë për pjesëmarrjen e juaj në anketë.

Vështrim historik i Horizonte

«Horizonte» botohet që nga viti 1998 si shtojcë e gazetave sindikaliste. Me këtë gazetë shtojcë, sindikatat e atëhershme GBI (Sindikata e Ndërtimtarisë dhe Industrisë) dhe SMUV (Sindikata e Industrisë, Tregtisë, Shërbimeve) u krijua një mjet informacioni për gjithë Zvicrën, e cila asokohe botohej nëntë herë në vit po në pesë gjuhë (Numri i ekzemplarëve në vitin 2001: gjithsej 53 450; nga ta: në sllavishten jugore dhe në shqip 19 450; portugalisht 17 000; spanjisht 11 300; turqisht 5700).

Fillimisht i paraparë si projekt trevjeçar «Horizonte» synonte të shfrytëzonte shumëllojshmërinë e gjuhëve. Me kohë, Horizonte arriti të bëhej një gazetë e Me kalimin e kohës, Horizonte arriti të bëhej një gazetë e qëndrueshme sindikaliste, e cila kontribuon në informimin e komuniteteve të migrantëve dhe perceptohet e konsiderohet si e tillë nga mediat tjera të migrantëve. Me kalimin e viteve Horizonte ka pësuar edhe ndryshime cilësore dhe sasore.

Në vitin 2011 janë publikuar gjithsej 51320 ekzemplarë të Horizonte. Në vitin 2018 Horizonte botohet shtatë herë në vit me gjithsej 56950 ekzemplarë (portugalisht 28760; shqip 9870; spanjisht 7760; serbisht-kroatisht-boshnjakisht 6720; turqisht 3840).

Horizonte sot

Gazeta raporton mbi aktivitetet e sindikatave dhe ofron informacion të dobishëm mbi atdheut të migrantëve dhe migrantëve. Përveç kësaj, Horizonte ofron informacion mbi politikën e migracionit në Zvicër dhe venë një fokus të veçantë në tema që mund të jenë me interes për grupet përkatës gjuhësore.

Përmes anketës deri tek përmirësimi i Horizonte

Përmes ankesës ne duam të dimë, se si perceptohet Horizonte nga lexuesit dhe lexuesit tanë. Me propozimet e juaja ne duam që të rrisim cilësinë e Horizonte. Anketa është anonime dhe mund të bëhet përmes formularit të bashkangjitur në këtë faqe. Ju lutem që ta plotësoni formularin. Na dërgoni një foto nga formulari i plotësuar në e-mailin: Migration@unia.ch, ose shkëputeni faqen me formularin e plotësuar dhe dërgojeni përmes postës në adresën:



Migration Unia Zentralsekretariat
VIP Vertrags – und Interessengruppenpolitik
Weltpoststrasse 20/PF
3000 Bern 15

ANKETË HORIZONTE 2018

1. Si ju pelqen «HORIZONTE»?

	Shumë mirë	pak mirë	pak keq	keq
Në përgjithësi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përzgjedhja e temave	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Vlera informative e shkrimeve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dobia praktike e shkrimeve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Kuptueshmëria e shkrimeve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Kuptueshmëria e gjuhës dhe termeve të përdorura	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Faqësja (dukja e faqeve)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2. Cilat rubrika dhe tema të «HORIZONTE» lexoni më së shumti?

Kjo rubrikë më intereson mua:	së tepërmi	shumë	pak	fare pak
Editoriali/Tema kryesore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Temat sindikaliste	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Puna dhe sigurimet shoqërore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Temat mbi migracionin	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mbrojtja e shëndetit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Lajmet e shkurtra	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Intervistat & Portretet	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Pyetje & Përgjigje	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Politika	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Artikujt gjuhësorë & dhe mbi vendin amë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Temat tjera (Sigurimi shëndetësor, tatimi, etj.)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

3. Shpeshësia (horizontet del 7 herë në vit)

A duhet të ndryshohet numri i botimeve vjetore të Horizonte?

të mbetet i njëjtë më shumë numra më pak numra

4. Cilësia

Nëse nuk ju pelqen diçka në «HORIZONTE»:

Çfarë nuk ju pelqen?.....

Çfarë duhet të ndryshohet?.....

5. Personale

| Gjinia? mashkull femër

| Sa vjeç jeni? 14 deri 19 vjeç 20 deri 29 vjeç 30 deri 39 vjeç
 40 deri 49 vjeç 50 deri 59 vjeç mbi 59 vjeç

6. Që kur je anëtar?

Qe 1 deri 6 muaj Qe 1 deri 2 vjet Qe 3 deri 5 vjet Qe 6 deri 10 vjet
 Më shumë se 10 vjet

7. Cila është gjendja juaj aktuale profesionale?

i/e punësuar punëtor/e profesionale Temporal/e Shegert/e
 Ushtrues/e profesionitë pavarur i/e papunë Amvis/e / Shtëpiak/e
 Pensionist/e Tjetër

8. Cila është arsimimi/kualifikimi juaj?

shkollimi obligator Matura /matura profesionale aftësimi profesional / Zanati
 Shkollimi i lartë pa profesion, apo aftësim tjetër fare

9. Vërejtje/Komente (A keni sugjerime për përmirësim/? Çfarë duhet ndryshuar?)

.....